



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 02.07.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Salih Salihu, Andin Hoti, Salih Zyba, Danush Ademi dhe Etem Arifi.

Munguan: Liburn Aliu dhe Sergjan Mitrovic.

I ftuar: Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku e Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.06.2019;**
- 3. Shqyrtimi i projektligjit për produktet biocide;**
- 4. Shqyrtimi i projektligjit për odën e arkitektëve dhe odën e inxhinierëve në fushën e ndërtimit;**
- 5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve memorialë të Kosovës për vitin 2018 – i plotësuar;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Fillimisht, **Salih Zyba**, në lidhje me rendin e ditës, kërkoi që të diskutohet për gjendjen e gurëthyesve, hidrocentraleve dhe niveli i bashkëpunimit me MMPH-në. Ai tha se pas vizitave të komisionit në gurëthyesit në Skenderaj, Malishevë dhe hidrocentralit në Biti të Poshtme, MMPH ka marrë për obligim të përgatitë një raport për gjendjen e tyre, mirëpo raporti nuk është sjellë dhe kjo është papërgjegjësi. Edhe pas vizitës që kemi pasur, kanë vazhduar punimet te hidrocentralet,

janë shterrë lumenjtë dhe kanë vazhduar edhe te gurëthyesit dhe ai kërkoi që të diskutohet kjo temë dhe niveli i bashkëpunimit me MMPH-në.

Kryetari, për rendin e ditës, tha se propozohet nga kryetari dhe gjithmonë është i hapur për propozimet e anëtarëve të komisionit. Ndërsa për propozimin e Salih Zybës, për shkak të efektivitetit, propozoi të caktohet një mbledhje tjetër me këtë pikë të rendit të ditës, për gjendjen e hidrocentraleve dhe të plotësohet edhe me gurëthyesit dhe të ftohet ministri i MMPH-së dhe përfaqësuesit e banorëve të fshatit si dhe paraprakisht të kërkohet një raport nga MMPH.

Ganimete Musliu, u pajtua me rëndësinë e diskutimit të kësaj teme, mirëpo për shkak të përgatitjes më të mirë të propozohet që kjo të bëhet në një mbledhje tjetër me këtë pikë të rendit të ditës (këtë javë ose javën tjetër).

Besa Gaxherri, për shkak të përgatitjes më të mirë, kërkoi që raporti nga MMPH-ja për këtë temë të dërgohet dy apo tri ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Kryetari, ftoi anëtarët e komisionit për votimin e propozimit të deputetit Salih Zyba, që sot të diskutohet për gjendjen e hidrocentraleve dhe gurëthyesve, si dhe për bashkëpunimin me MMPH-në, mirëpo propozimi nuk mori votat e mjaftueshme (4 vota për dhe 4 kundër).

Komisioni, vendosi që për temën e hidrocentraleve dhe gurëthyesve në përgjithësi dhe në veçanti për hidrocentralet dhe gurëthyesit që janë vizituar nga komisioni, të mbahet mbledhje në javën e ardhshme. Paraprakisht MMPH-së t'i kërkohet një raport dhe të ftohet ministri i MMPH-së dhe përfaqësuesit e banorëve.

Në fund, kryetari konstatoi se komisioni, miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 11.06.2019

Kryetari, konstatoi se komisioni, me 9 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, miratoi procesverbalin nga mbledhja dt. 11.6.2019.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet biocide

Kryetari e paraqiti për shqyrtim Projektligjin për produktet biocide dhe amendamentet e propozuara nga Grupi i punës, të cilin komisioni e ka formuar në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2019, në këtë përbërje: Salih Salihu-kryesues, Ganimete Musliu dhe Lutfi Zharku, anëtarë. Ai e ftoi kryesuesin Salih Salihu, t'i paraqet ato.

Salih Salihu tha se Grupi i punës së bashku me përfaqësuesit e MMPH-së, sponsrriuese e projektligjit, janë mbajtur 3 takime pune, ku është shqyrtuar projektligji dhe janë përgatitë 24 amendamente, të cilat i paraqiti në komision dhe i ftoi që të votohen dhe të përcillen te komisionet e përhershme për shqyrtim.

Pasi që nuk kishte diskutues të tjerë, kryetari ftoi anëtarët e komisionit për votim dhe konstatoi se komisioni, me 9 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, miratoi amendamentet dhe vendosi që komisioneve të përhershme t'ua paraqesë, këtë:

Raport me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-130 për produktet biocide

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 5, ndryshohet si vijon:

“Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren nr. 528/2012/EU- e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 maj 2012 lidhur me vënien në dispozicion të tregut dhe përdorimin e produkteve biocide.”

Amendamenti 2

Neni 2, nënparagrafi 1.1, numri romak **“II”**, zëvendësohet me **“2”** dhe në tërë projektligjin numrat romak të shtojcave zëvendësohen me numra arab.

Amendamenti 3

Neni 3, nënparagrafi 1.13 dhe në tërë Projektligjin, shkurtesa **“MMPH”**, zëvendësohet me **“Ministria”**

nënparagrafi 1.17, numri romak **“III”**, zëvendësohet me **“2”**

nënparagrafi 1.24, ndryshohet si vijon:

“Agjencia Evropiane e Kimikateve (ECHA) është Agjencia Evropiane e Kimikateve, si forcë lëvizëse midis organeve rregullatore në zbatimin e rregullave inovative të BE-së mbi kimikatet që fokusohen në mirëqenien e njerëzve dhe mjedisit, si dhe inovacionin dhe konkurrencën”

dhe në tërë projektligjin shkurtesa **“Agjencia”**, zëvendësohet me **“Agjencia Evropiane e Kimikateve”**.

Nënparagrafi 1.34, pas fjalës **“Hapësinor”**, fshihet pjesa tjetër

nënparagrafi 1.47. fjala **“Rretha”**, zëvendësohet me **“Rrethanë”**

Pas nënparagrafit 1.47, shtohen këto nënparagrafe të rinj:

1.48. **‘AMMK’** - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

1.49. **‘AUV’**- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;

1.50. **‘IKSHPK’**- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;

1.51. **‘MSH’**- Ministria e Shëndetësisë;

1.52. **‘BE’**- Bashkimi Evropian.

Amendamenti 4

Neni 4, paragrafi 2, fshihet **“(tani e tutje Agjencia)”**

paragrafi 3, numri **“10”**, zëvendësohet me **“10 (dhjetë)”**

Amendamenti 5

Neni 5, paragrafi 6, numri **“10 (dhjetë)”**, zëvendësohet me **“10 (dhjetë)”**

Amendamenti 6

Neni 6, paragrafi 5, numri **“6”**, zëvendësohet me **“6 (gjashtë)”**

paragrafi 12 dhe 13 numri **“365”**, zëvendësohet me **“365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë)”**,

paragrafi 13, numri **“180”**, zëvendësohet me **“180 (njëqind e tetëdhjetë)”**.

Amendamenti 7

Neni 9, paragrafi 2, në fillim pas fjalës **“nen”**, shtohet fjala **“nuk”** .

Nënparagrafi 3.1. në rreshtin e tretë fjala **“një prodhues”**, zëvendësohet me **“prodhuesi”**.

paragrafi 4, fjalët **“nënparagrafin e parë”**, zëvendësohet me **“paragrafin 3, të këtij neni”**

paragrafi 5, në rreshtin e tretë fshihet fjala **„sektorial”**.

Amendamenti 8

Neni 13, paragrafi 10, fjala **“pikat”**, zëvendësohet me **“paragrafin”**.

Amendamenti 9

Neni 17, nënparagrafi 2.7, pas fjalës **“Mjedisit”**, shtohet **“dhe Ujërave”**.

nënparagrafi 2.8, ndryshohet si vijon:

“të lëshojë leje për prodhimin, magazinimin, importin e produkteve biocide dhe licencën për dhënien e shërbimit me produkte biocide” .

Nënparagrafi 4.3, ndryshohet: **“Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë”** dhe në tërë projektligjin përdoret ky emërtim.

Amendamenti 10

Neni 18, nënparagrafi 2.3, fjala **“Ministri”**, zëvendësohet me **“Ministria”**.

Amendamenti 11

Neni 20, paragrafi 10, ndryshohet si vijon:

“Bordi për autorizim propozohet nga Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave dhe aprovohet nga Ministria për mandat 2 (dy) vjeçare nga dita e emërimit.”

Amendamenti 12

Neni 21, titulli ndryshohet si vijon: **“Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës”** dhe në tërë projektligjin përdoret ky emërtim.

Nënparagrafi 1.2, pjesa e fjalisë në fund pas fjalës **“informojë”**, ndryshohet: **“MSH-së dhe Ministrinë”**.

Amendamenti 13

Neni 22, nënparagrafi 1.1, pas fjalës **“informojë”**, pjesa tjetër ndryshohet **“Zyrën e Kryeministrit të Kosovës dhe Ministrinë”**.

Amendamenti 14

Neni 29, paragrafi 5, Shkurtesa **“DMM”**, zëvendësohet me **“Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave”**.

Amendamenti 15

Neni 30, paragrafi 1, numri **“5”**, plotësohet edhe me shkronja **“5 (pesë)”**.

Amendamenti 16

Neni 33, paragrafi 2, në rreshtin e parë, numri **“1”**, zëvendësohet me **“2”** paragrafi 3, numri **“10”**, zëvendësohet me **“10 (dhjetë)”**.

Amendamenti 17

Neni 35, paragrafi 1, shkurtesa **“EU”**, zëvendësohet me **“BE”** dhe **“KE”**, zëvendësohet me **“Komisioni Evropian”**.

Amendamenti 18

Neni 36, në fund të titullit fshihet germa **“t”**.

Amendamenti 19

Neni 38, nënparagrafi 1.2. dhe 2.1, fjala **“fuqishme të”**, zëvendësohet me fjalën **“zgjeruar e”** dhe pas presjes shtohet lidhëza **“ose”** .

Amendamenti 20

Neni 44, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

“Shpenzimet për Autorizimin e produkteve biocide dhe për lëshimin e Lejes për prodhimin dhe /ose magazinimin, Lejes për import dhe vënien në treg të produktit biocid, Aprovimin e substancës aktive, si dhe për Licencimin e personave për dhënien e shërbimit me produkte biocide, ose dhe të personave për përdorimin e produkteve biocide i bartë aplikuesi.”

Paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

“Ministria nxjerr akte nënligjore për përcaktimin e tarifave për mbulimin e shpenzimeve lidhur me zhvillimin e procedurës për lejet dhe licencën sipas paragrafit 1, të këtij neni, si dhe mënyrën dhe kushtet për pagesën e tyre.”

Amendamenti 21

Neni 45, paragrafi 5, fjala „**Inspektoratet**”, zëvendësohet me **“Organi kundërvajtës”** dhe fjala **“fito sanitar”**, shkruhet e ngjitur **“fitosanitar”**.

Amendamenti 22

Neni 46, nënparagrafi 1.19, fjala **“paragrafi 2”**, zëvendësohet me **“paragrafi 3”**.

Amendamenti 23

Neni 47, shtohet numri i paragrafit **“2”**.

Amendamenti 24

Neni 51, paragrafi 1, numri **“4”**, zëvendësohet me **“3”**
nënparagrafi 1.2, pas numrit të Rregullores, shtohet **“/EU”**

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit

Kryetari, e paraqiti për shqyrtim Projektligjin për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit dhe amendamentet e propozuara nga Grupi i punës, të cilin komisioni e ka formuar në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2019, në këtë përbërje: Liburn Aliu-kryesues, Etem Arifi dhe Danush Ademi, anëtarë. Me kërkesën e kryesuesit të grupit të punës i cili mungoi në mbledhje, kryetari i paraqiti këto amendamente në komision dhe tha se Grupi i punës së bashku me përfaqësuesit e MMPH-së, sponsorizuese e projektligjit e ka shqyrtuar projektligjin, si dhe vërejtjet e propozimet e ardhura nga shoqatat profesionale të inxhinierëve të ndërtimit, arkitektëve, etj., si dhe përgatiti 29 amendamente dhe i ftoi që të votohen dhe të përcillen te komisionet e përhershme për shqyrtim.

Kryetari, pasi që nuk kishte diskutues, ftoi anëtarët e komisionit për votim dhe konstatoi se komisioni, me 9 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, miratoi amendamentet dhe vendosi që komisioneve të përhershme t`ua paraqesë, këtë:

Raport me amendamente për Projektligjin Nr. 06/L-132 për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit

Amendamenti 1

Neni 3, nënparagrafi 1.16, titulli i përkufizimit, ndryshohet si vijon:

“Licenca e Kategorisë A dhe Licenca e Kategorisë B”

Nënparagrafi 1.20, fjala **“inxhiniri”**, bëhet **“inxhinieri”**.

Pas nënparagrafit 1.20, shtohet një nënparagraf i ri:

“Rilicencimi”- është vazhdim i afatit të vlefshmërisë së licencës sipas procedurave të këtij ligji.

Amendamenti 2

Në titullin e nenit 6 dhe paragrafin 1, fjala **“Funksionet”**, zëvendësohet me fjalën **“Kompetencat”**.

Amendamenti 3

Neni 7, paragrafi 6, pas fjalës **“lëshon”**, shtohet **“përgjigje në”** dhe teksti vazhdon.

Amendamenti 4

Titulli i nenit 9 plotësohet, pas fjalës **“Sjelljes”**, shtohet fjala **“Profesionale”**.

Paragrafi 1, fjala **“rregullohen”**, zëvendësohet me **“rregullon”**.

Amendamenti 5

Neni 10, nënparagrafi 1.2, ndryshohet si vijon:

“Procedurën për licencimin, rilicencimin, mirëmbajtjen, pezullimin dhe anulimin e licencës së anëtarit të licencuar të Odës”.

Nënparagrafi 1.3 dhe 1.5, fjala **“Procedura”**, zëvendësohet me **“Procedurën”**.

Amendamenti 6

Neni 11, paragrafi 3, fjala **“e përcaktojnë”**, zëvendësohet me **“përcaktohen për”** dhe fjala **“pranojnë”**, zëvendësohet me **“ushtrojnë”**.

Amendamenti 7

Neni 12, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

“Kuvendi i Odës përbëhet nga anëtarët e licencuar të Odës, me përjashtim të periudhës së përkohshme të themelimit të Odës, ku anëtarët e Kuvendit të Odës janë anëtarë të regjistruar sipas nenit 45 të këtij ligji.”

Amendamenti 8

Neni 13, paragrafi 2, referenca **“nenin 13”**, ndryshohet **“nenin 15”**.

Amendamenti 9

Neni 14, paragrafi 1, pas fjalës **“të barabartë”**, shtohet **“të anëtarëve të Kuvendit”**.

Amendamenti 10

Neni 15, paragrafi 3; neni 17, paragrafi 3; neni 18, paragrafi 4 dhe neni 19, paragrafi 5, pas fjalës **“3 (tri) vite”**, shtohet: **“me të drejtë rizgjedhje edhe një mandat tjetër”**.

Amendamenti 11

Neni 16, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

“Mandati i anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës të zgjedhur nga Kuvendi i Odës është 3 (tri) vite, me të drejtë rizgjedhjeje edhe një mandat tjetër”.

Nënparagrafi 3.4 ndryshohet si vijon:

“Mbikëqyrjen e punës së organeve të Odës, duke përfshirë edhe punën e Administratës së Odës”.

Amendamenti 12

Neni 17, nënparagrafi 5.2, referenca **“Neni 19”**, zëvendësohet me **“Nenin 20”**

nënparagrafi 5.7, ndryshohet si vijon: **“Mbikëqyrjen e standardeve të punës së anëtarëve të licencuar sipas detyrës zyrtare, të përcaktuara me aktet e Odës”.**

Amendamenti 13

Titulli i nenit 20, ndryshohet: **“Komisioni Vlerësues dhe komisionet tjera”.**

Amendamenti 14

Neni 22, paragrafi 1, pas fjalës **“aktet”**, fshihet fjala **“e tjera”**.

Paragrafi 2, pas fjalës **“akteve”**, fshihet **“të tjera”**

Amendamenti 15

Neni 23, paragrafi 1, pas fjalës **“nënligjore”**, fshihet fjala **“të miratuara”**.

Paragrafi 2, pas fjalës **“Inxhinier i licencuar”**, fshihet pjesa **“në fushën e ndërtimit”**.

Amendamenti 16

Neni 24, paragrafi 2, fjala **“të ri”**, zëvendësohet me **“të tjerë”**.

Amendament 17

Neni 25, paragrafi 2, pas fjalës **“anëtarësimi”**, shtohet **“pa të drejtë vote”**.

Amendamenti 18

Neni 26, paragrafi 7, referenca **“paragrafi 2.2”**, zëvendësohet me **“nënparagrafi 1.2”**, pas paragrafit 7, shtohen tre paragrafë të rinj:

“8. Vlefshmëria e licencës do të jetë 5 (pesë) vite dhe ajo do të përtërihet me rastin e aplikimit për rilicencim.”

“9. Procedurat e rilicencimit përcaktohen me Rregullore sipas nenit 10, nënparagrafit 1.2 të këtij ligji.

“10. Krahas procedurave për rilicencim të parapara në paragrafin 9 të këtij neni, duhet të dëshmohet edhe edukimi i vazhdueshëm profesional, i paraparë sipas nenit 32 të këtij ligji.

Amendamenti 19

Neni 30, pas nënparagrafit 1.5, shtohet paragrafi i ri me këtë përmbajtje:

“Periudha e vlefshmërisë së licencës”.

Amendamenti 20

Neni 34, paragrafi 2, në rreshtin e pestë, fjala **”nenit 34“**, zëvendësohet me **“me këtë nen”**.

Amendamenti 21

Neni 36, nënparagrafi 3.3, fjala **“palejueshëm”**, zëvendësohet me **“papranueshëm”**.

Amendamenti 22

Neni 38, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

“Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave mund të ushtrohet padi për fillimin e konfliktit administrativ në gjykatën kompetente”.

Amendamenti 23

Neni 39, paragrafi 2 dhe 3, bashkohen në një paragraf të vetëm si vijon:

“Parashkrimi për shkeljet disiplinore dhe ekzekutimi i masave disiplinore përcaktohen me Kodin e etikës dhe sjelljes profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji”.

Amendamenti 24

Neni 40, nënparagrafi 1.2, pas fjalës **“licencim”**, shtohet **“dhe rilicencim”**

Amendamenti 25

Neni 42, paragrafi 1, referenca **”nenin 40”**, ndryshohet: **“nenin 41”**.

Amendamenti 26

Neni 43, pas nënparagrafit 2.3, shtohen dy nënparagrafë të rinj:

“2.4. Licencimin e anëtarëve të Bordit dhe anëtarëve tjerë të komisioneve të Odës së Përkohshme, të cilët paraprakisht zgjidhen nga anëtarët e Kuvendit.”

“2.5. Anëtarët e Bordit drejtues dhe komisioneve tjera, duhet paraprakisht t’i plotësojnë kërkesat e nenit 26 të këtij ligji.”

Paragrafi 3, referenca **“paragrafin 4 të nenit 15”**, ndryshohet: **“nenin 16, paragrafin 3”**.

Nënparagrafi 3.4 ndryshohet si vijon:

“Mbikëqyrjen e punës së organeve të përkohshme të Odës, duke përfshirë edhe punën e Administratës së Odës”.

Pas paragrafit 3, shtohet një paragrafi i ri:

“Komisioni i Ministrisë për themelimin e Odës, merr vendim për licencimin e anëtarëve të zgjedhur për Bordin drejtues dhe anëtarëve të komisioneve tjera nga Kuvendi i Odës.”

Paragrafi 5 ndryshohet si vijon:

“Shërbimi në këtë komision krijon të drejtën për kompensim.”

Amendamenti 27

Neni 46, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

“Procedura dhe mënyra e nominimit për t’u zgjedhur si anëtar i Bordit drejtues ose anëtar i komisioneve tjera, në periudhën e përkohshme të Odës, rregullohet me akt nënligjor të përcaktuar me nenin 44 të këtij ligji.”

Pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri:

“Të gjithë anëtarët e nominuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet paraprakisht t’i plotësojnë kërkesat e nenit 26 të këtij ligji.”

Amendamenti 28

Neni 48, në titullin e nenit, pas fjalës **“organeve”**, shtohet **“të”**.

Amendamenti 29

Neni 51, në rreshtin e parë, numri **“6 (gjashtë)”**, zëvendësohet me **“12 (dymbëdhjetë)”**.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2018 -i plotësuar

Kryetari, rikujtoi se komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2019, e shqyrtoi Raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2018, ku i ftuar ishte drejtori i kësaj Agjencie, z. Bislim Zogaj. Në fund komisioni konstatoi se rekomandimi për raportin do të votohet, pasi që Raporti të plotësohet, në bazë të vërejtjeve dhe rekomandimeve të

dhëna nga deputetët. Agjencia e ka dërguar të plotësuar raportin dhe e ftoi drejtorin z. Zogaj, ti paraqes këto plotësime para komisionit, mirëpo shtoi se në seancë akoma nuk është votuar Raporti për vitin 2017.

Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë, tha se kërkesat e komisionit kanë qenë, për asetet dhe kërkesa shumë e arsyeshme për prezantimin e të gjithë lapidarëve në raport dhe në ueb faqen e Agjencisë. Kemi punuar mjaft, por nuk kemi mund të plotësojmë të gjitha për dy arsye: së pari nuk kemi pasur staf të mjaftueshëm dhe tani jemi kompletuar dhe jemi duke punuar intensivisht. Afër 50% e shënimeve me vendndodhjen, investitorin dhe koston, kemi arritur me i plotësuar.

Ndërsa kemi pasur pengesa nga komunat, edhe pse kemi kërkuar nga të gjitha komunat, ne asnjë informacion nuk e kemi marrë. Pastaj kemi kërkuar prej përfaqësuesve të fshatrave ku ka memorialë apo lapidarë dhe tash prej tyre po i marrim shënimet, por pengesë këtu ka qenë ajo se kryetarët e fshatrave janë ndërruar. Tani jemi në proces të mirë që shumë shpejt do t'i plotësojmë shënimet dhe pastaj do t'i fotografojmë të gjithë lapidarët dhe do t'i vendosim në ueb faqen e Agjencisë. Në raportin plotësues, kemi sjellë vetëm listën e lapidarëve, me vendndodhjen dhe koston, që ka qenë investim i Agjencisë dhe MMPH.

Kryetari pyeti drejtorin se kur prisni që të merrni edhe këto shënime dhe kur do të mund të presim në komision raportin e plotësuar. Dhe i pyeti anëtarët e komisionit se a do të presim edhe shënimet plotësuese para se me votuar raportin për seancë.

Ganimete Musliu tha se është shqetësuese që komunat nuk i kanë sjellë të dhënat dhe kërkoi nga drejtori ta sqarojnë këtë se në çfarë forme janë kërkuar dhe nga kush. Ndërsa për informacionet nga përfaqësuesit e fshatrave ajo tha se nuk mund t'i sigurojnë për 10 ditë dhe përfaqësuesit e fshatrave nuk e kanë obligim por vetëm nga vullneti i mirë dhe këto të dhëna mund të mos jenë të sakta. Ajo insistoi që të dhënat të kërkohen nga kryetarët e komunave sepse komunat kanë zyrtarë përgjegjës për këtë.

Besa Gaxherri tha se dëshiron të besoj se për 10 ditë shënimet do të plotësohen dhe për një muaj në ueb faqen dhe i përgëzoi për këtë, pasi që më herët s'ka pasur vullnet me i plotëso këto. Po presim që këto të dhëna të plotësohen dhe mos ta votohet sot. Për çështjen e lapidarëve tha se është shumë e ndjeshme dhe e shenjtë dhe shfaq dyshime për keqpërdorimet apo korrupsionin për ndërtimin e tyre.

Salih Zyba, kërkoi sqarime për hir të opinionit se pse “në strukturën organizative nuk ka bord”? pastaj tha se e çmon punën e bërë nga Agjencia sepse në këtë fazë është plotësuar me mbi 50% të shënimeve dhe jam për me dërguar përpara me një zotim për afatin se kur do të plotësohet me shënimet e tjera. Në fund ai tha se është shqetësuese se asnjë nga komunat nuk ka bashkëpunuar me Agjencinë dhe gjithashtu u pajtua me atë se të dhënat që mund të ofrohen nga përfaqësuesit e fshatrave mund të mos jenë të sakta.

Salih Salihu, për mosbashkëpunimin e komunave tha se është shqetësuese, dhe kryetarët e komunave i kanë të gjitha shënimet për lapidarët në çdo fshat dhe propozoi të kërkohet nga Agjencia takim me secilin kryetar dhe nëse ndonjë prej tyre nuk përgjigjet ne, si komision, mundemi me ndihmuar.

Drejtori i Agjencisë, **Bislim Zogaj**, në fund u përgjigj se: raporti me shënimet do të plotësohet brenda 2 jave, ndërsa në ueb faqe ndoshta më gjatë se një muaj. Për dyshimin se administratorët nuk mund të ofrojnë shënime të sakta, tha se ata janë adresë e qëlluar pasi që mbi 80 % e lapidarëve janë të ndërtuara në baza vullnetare, ndërsa për mungesën e bordit tha se kështu është e përcaktuar me ligj.

Kryetari, pas diskutimeve, konstatoi se komisioni vendosi që të presë Agjencinë në një afat prej dy javësh për plotësimin e këtyre të dhënave për lapidarët dhe pastaj të votohet rekomandimi për raportin.

4. Të ndryshme

Kryetari, propozoi formimin i Grupeve të punës për Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-247, që kanë kaluar në lexim të parë në seancën e datës 30.05.2019, mirëpo me kërkesën e deputetëve kjo u shty për një mbledhje tjetër.

Deputetja **Ganimete Musliu**, propozoi një vizitë në gurëthyesin në fshatin Gadime, ndërsa **kryetari** propozoi që të vizitohet edhe Komuna e Rahovecit, për problemin me rrugë për qasjen e banorëve në ara. Kjo vizitë u propozua të bëhet javën e ardhshme, pasi që nuk u përcaktuan për ditën e vizitës, mbetet që të njoftohen nga kryetari.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Muharrem Nitaj